



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 4163 prot.

Vlorë, më 19 03 2024

PROJEKT -VENDIM

PËR

**MIRATIMIN E VLERËS FINANCIARE TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA
DJEGIA E BANESËS TË Z.ROBERT SHËLLEGAJ DHE SHPËRBLIMIN
FINANCIAR NGA ANA E BASHKISË VLORË.**

Këshilli i Bashkisë Vlorë në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 2, neni 9/1 pika b, neni 29/1, neni 54 pika dh ,të ligjit nr.45/2019 datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile”,në VKM Nr. 329 data 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” paragrafi III/ë dhe pika 3/a, pasi mori në shqyrtim materialin e përgatitur nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Drejtoria e Financës dhe Këshilli i Qarkut Vlorë,

VENDOSI:

1. Të miratojë vlerën financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia në banesën e z.Robert Shëllegaj, e ndodhur në lagjen “Uji i Ftohtë”, Rajoni Nr.2, Bashkia Vlorë, në datën 05.12.2024, sipas preventivit të hartuar nga ekspertët e Këshillit të Qarkut Vlorë përkatësisht në masën:

A. 110.251 (njëqind e dhjetë mijë e dyqind e pesëdhjetë e një) lekë për punime ndërtimi (220.502x50%).

B. 501.263 (pesëqind e një mijë e dyqind e gjashtëdhjet e tre) lekë për mobilje dhe pajisje elektorshtëpiake.

- Shpërblimi financiar do të përballohet nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile të Bashkisë Vlorë.
- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financë-Buxhetit dhe Drejtoria e Mbrojtjes Civile pranë Bashkisë Vlorë.
- Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015, neni 55 pika .

Konceptoi: E. Kamberi

Miratoi: A. Vreshtazi

KRYETAR

ERMAL DREDHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 4163 prot.

Vlorë, më 19 03 2024

RELACION

PËR

PROJEKT-VENDIMIN "MIRATIMIN E VLERËS FINANCIARE TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA DJEGIA NË BANESËN E Z. ROBERT SHËLLEGAJ DHE SHPËRBLIMI FINANCIAR NGA ANA E BASHKISË VLORË "

Në zbatim të VKM Nr. 329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore".

Komisioni i Bashkisë Vlorë i ngritur me Urdhërin e Brendshëm Nr.301 datë 08.09.2023 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë ,shkoi në banesë për të konstatuar dëmet e shkaktuara nga djegia.

Robert Shëllegaj në datën 07.12.2023 ka paraqitur kërkesën me Nr.15304 prot, për shkak të djegies së banesës e ndodhur në lagjen "Uji Ftohtë", Rajoni Nr.2, Bashkia Vlorë.

Mbas hartimit të proces-verbalit të konstatimit të gjendjes së banesës në datë 11.12.2023, është vijuar me shkresën përcjellëse me Nr.15304/1 prot, datë 26.01.2024 Dërgohet dokumentacioni për banesën e djegur të z.Robert Shëllegaj, në Këshillin e Qarkut Vlorë për të vazhduar me preventivat e vlerësimit të dëmeve nga komisioni i ekspertëve.

Këshilli i Qarkut Vlorë me shkresën Nr.2635, datë 20.02.2024 "Dërgim preventivi dhe dokumentacioni i banesës së djegur të z.Robert Shëllegaj ka dërguar preventivin e hartuar nga komisioni i ekspertëve, nga ku rezulton:

- Vlera e dëmeve në banesën e z.Robert Shëllegaj është 611.514 (gjashtëqind e njëmbëdhjetë mijë e pesëqind e katërbëdhjetë) lekë.

Aktualisht Bashkia Vlorë ka mundësi financiare për të ndihmuar familjet për banesat e djegura.

Për sa më lart i kërkojmë Këshillit të Bashkisë të miratojë vlerën financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia në banesat e z.Robert Shëllegaj sipas preventivit të hartuar nga ekspertët e Këshillit të Qarkut Vlorë dhe shpërblimin financiar i cili do të përballohet nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile të Bashkisë Vlorë.

Konceptoi: *E.Kamberi*



DREJTOR

Adrian Vreshtazi

